

**EUPHEMISMS IN THE AREA OF POSTRIBA, PART OF NATIONAL
ETHNOLINGUISTIC PROPERTY**
**EUFEMIZMAT NË KRAHINËN E POSTRIBËS, PJESË E PASURISË
ETNOGJUHËSORE MBARËKOMBËTARE**

Majlinda BUSHAJ¹

^{1*} *University of Shkodra „Luigj Gurakuqi“*

**Corresponding author e-mail: bushajmajlinda@gmail.com*

Abstract

Euphemisms are an important linguistic feature. They are used to name those words that cannot be said by their real name. The area of Postriba besides wealth and diversity of words and idioms from various fields of social life is also rich in euphemisms. The aim of this study is to explore euphemisms that are used in the area of Postriba and analyses their semantic and structural features. In this work there are expounded and analyzed euphemisms that connected with taboo words like death, birth, medical conditions etc. Euphemism is a widespread language phenomenon and indispensable lubricant in language communication. It is an expression, which can show politeness, ease the tone and coordinate the personal relationships. They serve to enrich the vocabulary of a language. Euphemisms are used to replace designations for animals, sickness, birth, death, sex etc.

If we classify them according to the semantic feature, we could draw a map of these euphemisms denoting: euphemisms about diseases, death, religious terms, Euphemisms related to the name of the man or the woman etc. As we all know, euphemisms are rich in people's daily communication. It can help people form a positive communicative atmosphere to establish harmonious social relationships and eventually to achieve communicative goals. With the development of modern society, it has become an indispensable element in people's interaction. The findings also reveal that taboos and euphemisms are deeply rooted in the Postribas' cultural, religious norms and beliefs which affect their views and attitudes. Euphemisms have value even in our days, because through them we become acquainted with the history of different peoples, with antiquity, national peculiarities of the people, the language of religion etc.

Keywords: *euphemisms, Postriba, semantic peculiarities, formation, taboos.*

Eufemizmat janë një veçori e rëndësishme gjuhësore. Ato përdoren për të emërtuar ato fjalë që nuk mund të thuhet me emrin e tyre të vërtetë. Gjuha shqipe krahas pasurisë dhe larmisë së fjalëve dhe njësive frazeologjike nga fusha të ndryshme të jetës shoqërore është e pasur edhe me eufemizma të cilat përdoren për të zëvendësuar ato emërtime që populli nuk dëshiron t'i quajë me emrin e tyre të vërtetë. Ato lindën në shoqërinë primitive dhe shumë prej tyre janë të lidhura me fenë dhe besëtytninë. Njerëzit në kohët e lashta besonin se gjuha nuk ishte thjesht një simbol, por njëkohësisht ajo kishte edhe një pushtet magjik. Ajo mund t'u sillte njerëzve në të njëjtën kohë edhe fatkeqësi edhe mbarësi, prandaj vetë njerëzit i shmangnin nga përdorimi fjalë të tilla të konsideruara tabu dhe zëvendësohen nga shprehje të tjera të përafërta.

Eufemizmat kanë vlerë edhe në ditët tona, pasi përmes tyre njihemi me historinë e popujve të ndryshëm, me lashtësinë, veçoritë kombëtare të popullit, me të folurit e figurshëm të gjuhës popullore etj. Tabutë dhe eufemizmat lidhen, para së gjithash, me botën mitologjike, me mitet e besimet me burim vendës, janë shprehje e ruajtjes së veçorive kombëtare të popujve. Këtu pasqyrohet më së miri të folurit e figurshëm të gjuhës popullore.⁸⁶ Në studimet shqiptare mbledhja e eufemizmeve fillon me F. Bardhin, e më pas me P. Bogdanin. Më pas pasqyrimi i tyre u bë në fjalorë si ai i Kristoforidhit, në shumë fjalorë dygjuhësh shqip-gjuhë e huaj, në *Fjalorin e gjuhës shqipe* 1954, *Fjalorin e gjuhës shqipe* 1980, *Fjalorin e* 1984, *Fjalor i shqipes truallësore të Maqedonisë*, 1998⁸⁷, *Fjalorin e* 2006, *Fjalor i fjalëve dhe i shprehjeve të Kosovës* 2018⁸⁸ etj.

Nga albanologët e huaj ka qenë G. Hahn me veprën “*Studime shqiptare*” e më pas Nobert Jokli, G. Majer me fjalorin e tij, Nopça me zakone në Shqipëri, A. Millet me një studim ku eufemizmat i jep në planin krahasimtar me gjuhë të tjera indoevropiane. Ndërsa K. Treimer me veprën e tij *Gjuhësia* për tabutë e shqipes.⁸⁹ Në gjuhësinë shqiptare eufemizmat janë bërë objekt studimi nga gjuhëtarë të ndryshëm si: Çabej, Kostallari, Kristoforidhi duke vijuar me studiuesit më të ri, Shkurtaç, Biba etj. Punimi më i plotë deri më sot mbetet vepra e T. Osmanit-S. Pepës “*Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*” e cila përmbledh të gjitha studimet e bëra mbi këtë kategori fjalësh deri në hartimin e veprës. Pas botimit të kësaj vepre janë botuar artikuj të tjerë nga Durmishi⁹⁰, Shkurtaç⁹¹, Biba⁹², etj e së fundmi *Fjalori* i Ibrahimit⁹³.

E. Çabejt i mbetet merita që duke na dhënë përkufizimin e termit eufemizëm, shtroi edhe idetë e vijat më kryesore se si mund të mbërrihej në një njohje sa më të mirë të tyre nëpërmjet mendësisë dhe dokeve shqiptare, por edhe më gjerë, si shfrime të një mendësie popullore të hershme që na shfaqet pak a shumë njësoj si ndër shqiptarë ashtu edhe në popujt e tjerë. Me rëndësi është se Çabejt i kundroi eufemizmat në lidhje të ngushtë me besimet e mendësinë popullore të periudhave primitive, duke operuar mbi të dhënat e etnologjisë moderne.

A. Kostallari, duke u marrë me studimin e kompozitave dëshirore dhe urdhërore të shqipes ka shënuar edhe disa eufemizma nga kjo gjuhë, vjelë nga letërsia gojore ose nga folklori, të cilat i sheh në rrafshin gjuhësor⁹⁴.

Në veprën e **Osmanit-Pepës** ndeshim një pasqyrë të trajtimit leksikografik të eufemizmeve të gjuhës shqipe. Kjo vepër u jep dorë studiuesve dhe krijon mundësi për analiza e studime më të thelluara për njësitë eufemistike të gjuhës shqipe duke i vështruar ato nga pikëpamja e strukturës formale dhe semantike.

⁸⁶ Osmani T, Pepa S. *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, Shkodër 2000, f. 5.

⁸⁷ Murati Q. *Fjalor i shqipes truallësore të Maqedonisë*, Tetovë, 1998.

⁸⁸ Murati Q. *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës*, Prishtinë, 2018.

⁸⁹ Cituar sipas T. Osmanit, *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, Shkodër, 2000, f. 12.

⁹⁰ Durmishi I. *Tabutë dhe eufemizmat*, Seminari IV Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2010; *Eufemizmat si dukuri gjuhësore me karakter sociolinguistik*, Seminari VI Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2012; *Eufemizmat si shprehje tipike e gjuhës së grave*, “Studime Sociolinguistike, 2014, nr.2, f.66-72; Funkcionalizmi si metodë gjuhësore tek eufemizmat”, “Albanologjia”, vol. 3, nr.5-6, f. 28-32, Tetovë, 2016; *Ndërlidhja e eufemizmeve me luftën*, botuar në “Albanologjia”, nr.7/2017 etj.

⁹¹ Shkurtaç Gj. *Eufemizmat si shprehje e etnografisë së të folurit grarisht*, Etnografi e të folurit të shqipes, Tiranë, 2015, f.259-270.

⁹² Biba E. *Eufemizmat në “ligjërimin grarisht” të trevave të Korçës*, “Buletini shkencor” i Universitetit “Fan S. Noli”, nr. 8. (2004); Biba E., *Vlerat etnolinguistike të këngëve të festave popullore në rrethin e Korçës*, “Buletini Shkencor” i Universitetit “Fan S. Noli”, nr.6. (2004).

⁹³ Ibrahim M. *Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmeve shqiptare*, Interlingua, Shkup, 2009.

⁹⁴ Kostallari A. *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, nr.I, Tiranë, 1972, f.184-190.

I. Durmishi me një varg artikujsh⁹⁵ për eufemizmat e gjuhës shqipe dhe më gjerë ka merita të veçanta, sepse ai duke njohur dhe kuptuar gjithë sa ishte shkruar për eufemizmat e tabutë në shqipen para tij, plotësoi atë pjesë të shqipes në trojet jashtë Shqipërisë, veçanërisht të shqiptarëve në Maqedoni.

Fjalori i **M. Ibrahimit** na jep një pasuri interesante, e cila ngulitet për këtë fazë të shqipes dhe do të shërbejë me dobi të madhe edhe më tej, sepse jep mundësinë që në të ardhmen të bëhen krahasime, të cilat i vlejné studimit të ecurisë së shqipes. Është meritë e veçantë e autorit, që ka arritur të gjurmtojë kuptimet e këtyre mjeteve, të cilat shpesh janë jo edhe aq të përcaktuara për vetë folësit që i përdorin. Me interes janë vëzhgimet për komunikimin e sotëm elektronik sidomos ndërmjet të rinjve. Përgatitja dhe botimi i Fjalorit të zhargoneve të shqipes nga prof. Mustafa Ibrahimit është një sukses i leksikografisë sonë dhe besoj do të nxisë edhe autorë të tjerë ta ndjekin këtë shembull. (Lloshi 2009:8)

Natyrisht kur flasim për eufemizmat kemi parasysh edhe tabutë (tabu është fjalë me origjinë polineziane dhe do të thotë ndalim). Me të drejtë prof. Çabej i quan “një urë që të shpie nga gjuha në folklor”. Ai i trajton eufemizmat e shqipes në një kuadër të gjerë e të hapët, duke krahasuar ato me eufemizmat e Ballkanit e më gjerë. Ai kishte vërejtur se eufemizmat si dukuri gjuhësore që i takojné shqipes, por edhe gjuhëve të tjera kanë shtrirje më të madhe në të folmet popullore. Këtu mund të kuptojmë ndërlidhjen e ngushtë të këtyre shprehjeve me gjuhën popullore. Eufemizmat zbulojné mendësitë e lashta që i ndeshim te popujt e tjerë të Ballkanit. Për t’u mbrojtur nga e keqja emri i drejtpërdrejtë i dukurisë ndalohej kthehej në tabu. Sot zhvillimi i shoqërisë i ka zbehur këto tabu, apo mendësi, por ka akoma arsye pse i përdorim eufemizmat si: etika në komunikim.

Eqrem Çabej shprehej se *studimet e mëtejshme* do të japin materiale të reja leksikore, por ky shqetësim ngrihej edhe nga autorët e mëvonshëm në parathënie të veprës “kjo fushë duhet të zgjerohet dhe të pasurohet më tej. (Osmani-Pepa 2004:4). Duke ecur në vazhden e këtyre studimeve po paraqes eufemizmat e zonës së Postribës, të cilat janë pjesë e pasurisë etnogjuhësore mbarëkombëtare.

Në vijim po paraqes disa eufemizma që kanë të bëjnë me fjalë tabu si: vdekja, lindja, sëmundje të ndryshme etj. Materiali eufemistik është është mbledhur nga ana ime në 12 fshatrat e Postribës, si dhe kam lexuar e shfrytëzuar studimet e artikuj të botuar për këtë temë. Izmit Durmishi shprehet se “historinë njerëzore po edhe atë gjuhësore e karakterizojné ndalesa të ndryshme, të ashtëquajturat “tabu” (Durmishi2010:117). Sipas Durmishit tabutë gjenden sidomos në krahina malore, në të cilat fshihet një botëkuptim i vjetër, ndonjë herë edhe me gjurmë mitologjike. Dukuri e tabuve ndeshet edhe në krahinën e Postribës.

Aktualisht dukuria e tabuve dhe e eufemizmeve është e gjallë në të gjitha brezat, por ka edhe mjaft ndalesa te brezi i ri si p.sh.: Kështu është quajtur dhe quhet e ndaluar ndeshja me fshesë e fëmijëve sepse *mund t’u tretet fara*, thuhet “*kur nesh ken me shi:s âsht zakon me e pshy shisen tri herë se ke nesh i tret fara dhe nuk shtohet*”; shkelja me këmbë e *dramcave të bukës*, sepse *mund të hasësh n xhin dhe shitolesh*, një gruaje që lind shumë vajza, vajzës së fundit i vihet emri i nënës, që të mos lindë më; shkelja e flokëve *sjell dhimbje koke*; hukatja e kripës tri herë *të shpëton nga syri i keq*, dita e martë *sjell tersllëk*; *kur këndojnë pulat në shtëpi* lindin vetëm vajza; për të mos e

⁹⁵ Durmishi I. *Tabutë dhe eufemizmat*, Seminari IV Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2010, f.116-123; *Eufemizmat si dukuri gjuhësore me karakter sociolinguistik*, Seminari VI Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2012; f.49-52; Funkcionalizmi si metodë gjuhësore tek eufemizmat, “Albanologjia”, vol. 3, nr.5-6, f. 28-32, Tetovë, 2016; *Eufemizmat si shprehje tipike e gjuhës së grave*, “Studime Sociolinguistike, 2014, nr.2, f.66-72; *Ndërlidhja e eufemizmeve me luftën*, botuar në “Albanologjia”, nr.7/2017 etj.

marrë fëmijën e vogël *msysh i bâjn marshalla dhe i fusin pështymën e vet plakat*, nusja kur të martohet duhet të hyjë në shtëpinë e burrit me këmbën e djathtë, *se me hî me të majtën të prihet mrapsht* etj.

Ndalea të tjera në lidhje me martesën, janë edhe qëndrimi i vajzës së pamartuar në pragun e shtëpisë, *bëhesh me fjalë*; rënia e luleve të nuses në tokë ditën e martesës *sjell prishje të martesës*, kush e pret tufën e luleve që hedh nusja kur e pret një vajzë e pamartuar *i çilet rrisku shpejt*, ngrënja e tallaskës së bagëtisë nga të pamartuarit *u nxin fytyrën ditën e martesës*; thyerja e një pasqyre nga një vajzë e pamartuar do të *thotë se i shtyhet për shtatë vjet rrisku*, mos me shku me rroba të zeza në jasë, sepse nusja që është duke u martuar *kalon në jasë shpejt* etj.

Tabu në lidhje me vdekjen, *mos shkel n u:j t vdekunit se t merr mrapa*; kur del prej vendit ku ka ndodhur vdekja nuk bën me bërë vizita te një shtëpi tjetër, sepse mund *t'i afrojë vdekjen* vendit tjetër ku shkon etj. Nëse ke qenë në varrim duhet të lash duart dhe fytyrën dhe hedhësh ujë prapa shpine tri herë *për mos me marrë vdekjen me vedi*. Në atë shtëpi që ndodh vdekja nuk fshihet më *shisë*, por me *post*, ose *qylym*, *prite zot rrezikun se ikin edhe t tjeret*. *Shpin e shishin me havli se t merr bereqetin i dekuni, ka:n vu edhe i co:p buk me t lan bereqetin* etj.

Në disa fshatra të Postribës, si: Drisht, Mes, Myselim, Boks, Dragoç etj. nuk duhet të djegësh bishtat e qepës, meqë mbahej bimë e shenjtë dhe është një nga kulturat kryesore të asaj zone. Po dogje qepën, - thotë posrripori, -tymi ngjitet drejt e në qiell e të paditë. Andaj, për atë që e djek këtë bimë thuhet: ai është njeri i keq *se djek edhe qepën*. (Osmani-Pepa 2004:7). Futja e hudrës fëmijës në xhep i largon *syryn e keq*, nënat ruajnë kërthizën e fëmijës së porsalindur që ta vendosin si hajmali në qafë e mbron nga *sëni i keq* etj.

Në rastet e udhëtimit, nëse niset dikush për rrugë të gjatë zakonisht jashtë shteti nuk *bân me shi shpi:n se nuk i prihet ma:r njat ditë*. Pastrimi i shtëpisë pasdite, *me shi çajt masdite s bân ene oborrin masdite s ban âsht keq, nuk prihet ma:r shpi:s*. Lyerja e fëmijëve me *zhigë zjermi* për të mos i *marr msysh tjerët është traditë e banorëve të Postribës*. *Kur âsht martu nusja i kan vu: nji do:r n sheqer e n bu:k se vjen me bereqet*. Në rastet e sëmundjeve të syrit hedhja e qumështit të gjirit të një nuseje të re e shëron atë. Kolla e mirë shërohet me *tâmël gomarice*.

Në rastet e largimit të një bagëtie nga shtëpia, *i hjekin tri qime lesh të saj që të mos na qe marrin bereqetin me vedi*. Kur mbidhet toka, punëtorët që hedhin farën duhet të *ulen nej* të pushojnë pak, *që të lajnë bereqetin e mos ta marrin me vete*. Prerja e thojve në shtëpi brenda nuk lejohet, sepse *nuk ka bereqet shpija*; tundja e duarve të lagura mbi *shpyret* sjell dridhje të duarve në pleqëri, nuk lejohet t'u hysh në mes tubës së bagtive *se âsht keq e nuk vo:jn ma:r* etj.

Tabutë në gjuhë janë të pranishme qysh herët që nga paraqitja e mendimit religjioz, fjalë të caktuara si p.sh. fjala *Zot*, nuk është lejuar as të përmendet me gojë as të shkruhet. Një dukuri të tillë e ndeshim edhe në gjuhë të tjera. (Durmishi 2012:265). Edhe në mjediset shqiptare siç shprehet Shkurtaç, kjo fjalë ka pasur gjithandej zëvendësime me shprehje perifrastike eufemistike. (Shkurtaç 2003:230). Edhe në këtë të folme ndeshim mjaft zëvendësime me shprehje eufemistike si: *Pasha njat qî s'ka mî te, pasha njat qî na run di:t e nat; pasha njat qî ka fal shtat fî to:k e shtat fî qiell, ai qî sheh nelt lumtna për te*: etj.

Eufemizmat dhe shprehjet eufemistike i ndeshim edhe në përdorimit të një fjale kur nuk duam ta zëmë në gojë dhe, me këtë rast përdorim shprehje që kanë kuptim të zbutur. Eufemizmat përdoren për të zëvendësuar emërtime për kafshët, për sëmundjet, për lindjen, vdekjen, seksin etj.

Sëmundje të ndryshme: Një fushë mjaft e pasur me eufemizma është ajo e sëmundjeve. Këto eufemizma dalin të larmishme si nga ana kuptimore, ashtu edhe nga ana strukturore. Banori i Postribës mendon se duke mos e përmendur emrin e vërtetë të sëmundjes, ajo largohet. Eufemizmat për sëmundjen janë të llojeve të ndryshme si: për epilepsinë, për kancerin, për gripin, për pleuritin, për paralizën etj.

- **Epilepsia.** Kjo sëmundje paraqet interes për vlerat leksiko-semantike që mbart dhe për shumësinë dhe shumëllojshërinë sinonimike dialektore për të cilën në Postribë ndeshim shprehjen eufemistike. “*e ka kap s'muna e tó:ks*. Ka qenë zakon se kur përmendej kjo sëmundje afër fëmijëve me prek veshin e secilit që është në dhomë zakonisht fëmijëve të vegjël, me qëllim që sëmundja të mos kapë asnjërin prej tyre, personi kur përmend emrin ndesh murin ose një objekt dhe fjala e tokës nuk përmendet: *i ka ra smuna e lngats; e preku ajo larg qoftë gurit e murit* etj.

- **Reumatizmi:** *e ka kap jeli. Ma merr një brezd leshit ta ve se m ka kap jeli.*

- **Kanceri:** *i ka gri stërgjija; e ka kap dergja e keqe* etj.

- **Tuberkulozi:** *i ka kap veremi, e ka kap smuna e keqe.*

- **Gripi:** *i ka ra flama, U ka ra flama tan robve t shpi:s goditni shërbet t xe:t ene ta:mël t xe:t ene ka:mt n uj t xe:t se ju provollit.*

- **Paraliza:** *i ka ra pika. Ka met vizak rat se i ka ra pika ene nuk lëvis duhet me i dha:n bu:k me do:r e uj me lug âsht me t mi:r e me t keqe n dyshek.* Ndeshim edhe mallkimet: **T raftë pika! T dhaça u:j me lug!**

- **Sëmundja pleuriti:** “*ka bâ ujë në mushkni*”; *I ka tha flama n azade e ka bâ uj n mushkni.*

- **Sëmundje e gishtit** “*i ka ra qimja n'gisht*” Ndeshim mallkimin: *T raftë qimja n gisht!*.

- **Sëmundje infektive e syve:** “*i kan dal shknija*”; *I ka dalë rrcylli=* kur âsht një femën shtatzanë kur rrcylli, del në pjesën të sipërme të syrit lind djalë, kurse kur del poshtë lind vajzë. *T ka:n vu: perde sytë = pse nuk e shiqon i kët gjâ â t ka:n vu perde sytë.*

- **Sëmundje e lëkurës skabja** “*i ka ra kroma*”. *Lamja me fi e ka largu kromen* etj.

- **Tifoja:** “*e ka kap barku i zi, âsht me bark t'zi*” etj. *Tifoja e zorrëve âsht barku i keq ose barku i zi.*

- **Plasja e bagëtive:** *dergjja e madhe.*

- **Shytat:** “*i kan dal ajasmal, i kan dal domllat* etj.

- **Pertusis** kolla “*i ka ra kolla e bardhë, i ka ra kolla e mirë*” etj.

- **Liqenia** “*i ka ra lija*”; Mallkim: *T raftë lija aty ku qosh!*

- **Temperatura e lartë** “*âsht ne:z flak fmija, qyqja për mû*”; *i ka hî zjerme n trup* etj.

- **Difteria** “*i ka ra hardhuca n'fyt*”;

- **Zjarri i natës** ose **dora asllan** “*të kuqt e madh*”;

- **Hemoragji cerebrale** “*i ka ra era e piks*”;

- **Askaridet** “*buba*” etj. *A mush n buba fmija qyqja ũ!*

- **Diabeti:** Eufemizmat kanë një ndikim të rëndësishëm në shëndetin e pacientit si: *thuhet smuna e sheqerit âmëlcina nuk lejohet me hangër amëlcina.*

Vdekja: Në të folmen e Postribës janë përpunuar rite të tëra për këtë ngjarje të hidhur të familjes. Qëllimi i tyre ka qenë për t'i mbyllur rrugën vdekjes. Besimi te jeta e përtejme dhe te mundësia që “shpirtërat” e të vdekurve që të pushojnë rehat, janë pjesë e këtyre ndalesave. Shpeshherë në tonet e tyre mbizotëron një ton dëshpërimi, sidomos kur përmendin të vdekurin mashkull. Populli thotë: *Diq fatbardhi e me:t fatzeza.*

Thënie dhe ndalesa në lidhje me vdekjen: Për të vdekurin thuhet: *Shyqyr si e ka rehatu zoti!. Na kena ardh kur ka ken gjallë aj jetshkurtumi.* Eufemizma të shumtë dalin dhe për të vdekurin dhe për vdekjen. *Haj bre se ska pas tjetër rrugë; ia myll dera me therrë* “thuhet kur vdes një djalë në shtëpi, i vetëm e nuk lë pasardhës të tjerë djem në shtëpi si: **të shkretat** (thuhet për bijat e shtëpisë kur u vdes vëllai) *ia mbyll dera me ferrë; për të vdekurin* thuhet *iu ndalu fryma; janë maru ditët; e ka hangër livadin; e ka marrë mordja, i ka ardh exheli* etj.

Edhe ngushtëllimet për raste vdekjeje në zonën e Postribës kanë ngjyrim zbutës. *Mos delsh për t'keq mbas sodit!; iu pastë marrë të keqen!, zoti u dhashtë kyvet!, zoti u forcoftë!, ishalla u ka lanë nafaken!, iu ardhshim për t mi:r mas sodit!, Ishalla dalim për mirë mas sodit!* etj. Në brezin

e vjetër thuhej *po shkojmë me u pjekë*, ndërsa brezi i ri *po shkojmë me u pa*. Në traditën e Postribës është zakon që emri i të vdekurit u vendoset fëmijëve të vegjël që të trashëgohet, brez pas brezi pasuria. Është zakon që njerëzit kur shkojnë në varrim nuk duhet të hyjnë në shtëpitë e të tjerëve se thuhet *se ndjell vdekjen*. Mënyra se si përmendet i vdekuri tregon për nderimin (ose të kundërtën) që kanë njerëzit për të. I vdekuri quhet *ai qî shkoi n qiell, jetprishmi, ai qî rahmet pastë, jetshkurtumi, rahmetliu; aj qî rahmet i pa:st gjet shpirti* ose eufemizma me ngjyrim keqësues si: *ai qî i ka hangër shpirti thera; po ja bâjm hallall qatî merhumi* etj.

Për lindjen: “u lirua” etj. Si urim përdoren shprehjet: *Ishalla ka li:n me jet t’gjatë* etj. Gratë e reja kur janë në prani të meshkujve, fjalën *sisë* e mënjanojnë duke përdorur fjalë me kuptim të figurshëm si: *I jap me pi fëmijës*. Për të mënjeluar fjalën *sisë* ato përdorin fjalët “*thithka*”. *Gruaja pa ba 5 javë nuk â leju me ja dhanë dorën kujt qî âsht me gji, ose me i dhân tesha kujt as kafen mos me ja nxjerrë/njî gru me gji nuk ba:n me u has me një gru tjetër me gji se humbet tâmlin* etj. *Nuk i tregohet kuj se je tuj shku me lindë se mendohet se zgjat lindja*. Sa më shumë ta dinë njerëzit aq më shumë zgjat lindja. *Shygyr qî ke pshtu kryt, Shygyr qî t ka pshtu zoti!* Kur gruaja lind vajza pas njëra - tjetrës dhe në fund lind djali, vajza përpara djalit quhet *kâmsheqere* etj. Kur gruaja lind vajza rresht dhe dëshiron t’i ndalen lindjet i vendos emrin e saj vajzës së fundit me qëllim që të mos lindë vajzë më. *Kur ka ndie lëvizjet e para të fëmijës në bark thuhet* që fëmija i ngjan atij personi që ka qenë afër nënës.

Për menstruacionet: *zakone, mujore, ato të grave* etj. *Sa dhimat i kam kur m’vin ato t’gravet; mujoret i kam me dhima* etj.

Për shtatëzaninë: Gratë parapëlqejnë fjalën “e rëndë” por dalin edhe shprehje të tilla si: *âsht me barrë; ka met e rân; sikur duket kam xân vend; jam nalue; më duket e hanri edhe i her hesapin* etj.

Aborti: *Ajo e humbi fëmijën, ka dështue pa dashje, ka:n qît zogun* etj.

Vezët e pulave: Në traditën e Postribës, si mjekim popullor në rastet e thyerjeve të ndonjë pjese të trupit, kur i kapte njerëzit ndonjë dhimbje në brinjë, ose në raste djegiesh përdornin vezët të cilat i emërtonin “*aso pulash*” p.sh.: *Ma the nî aso pulash se kam nî dhimë n’bri e noshta po m’pushon; A djegë fmiija theje nî aso pulash e djegje t’kuqin se duhet me ja vu fmi:s n’pla:g; Ka qît plaku kâmen merr do lesh t’palam e theje nî aso pulash e pshtjellja se â ka i dhem beqe* etj. *I ka dhimtë fmisë nëpër bark i kana hje:dh vene nëpër bark, ku ja hapë kana tha:n ka dhi:m* etj.

Emri i bashkëshortes (bashkëshortit) tabu. Në grupin e eufemizmave në zonën e Postribës bën pjesë edhe mospërdorimi i emrit të gruas ose burrit nga bashkëshortët. Më të zakonshmet kanë qenë **ai, ajo, ky, kjo**, ose **baxhi** për gruan. Për të mos përmendur emrin e bashkëshortit, burri e thërriste gruan në emrin e njëres prej vajzave dhe gruaja në emrin e njërit prej djemve. Në mungesë të një ndërmjetësi apo të kushteve për ta thirrur me nënkuptime të tilla, atëherë përdoreshin edhe fjalë të tjera *baxhi, o ti gruaja, o ti burri, nrikull, kumbar* etj. Në vitin e parë të martesës i thotë burrit “*ky*”, pas dy vjetësh i thotë “*aj*” ndërsa në pleqëri “*gjysh*”.

Tema e seksit ka qenë dhe mbetet një nga shqetësimet më të mëdha në jetën njerëzore që shkakton shqetësim ajo është një burim i fortë për eufemizma në popujt perëndimorë të të gjitha moshave. Kjo ka qenë një temë që në periudhat historike. Nuk po ndalemi në eufemizmat e njerëzve, sepse një studim të plotë e ndeshim në veprën e Ibrahimit (Ibrahimi 2009), por po trajtojmë disa elemente në lidhje me kafshët.

Ndërzimi i kafshëve: Në Postribë **blegtozia** është mjeshtria kryesore e katundeve malore, por edhe atyre fushore. Populli i kësaj treve e ka trashëguar nga brezi në brez mjeshterinë e bujkut dhe të blegtorit, për mbarështimin e bagëtive. Këtu mbizotërojnë bagëtitë e imëta dhe gjedhet.

Të shumta e të larmishme janë edhe emërtimet eufemistike për kafshët për procesin e fekondimit. Fjalët që lidhen me seksualitetin e kafshëve janë të shumta, përfshirë edhe emërtimin e pjesëve të trupit të kafshëve. Përmendim ndër të tjera:

- Për lopën “*ethet*”, por ndeshim edhe shprehje të tjera eufemistike si: *ka ra lopa n'ka; duhet me përcan lopen; janë kthy lo:pt mrapa;*

- Dhia: *ka ra dhia n'cjav; a thërpu dhija; janë marrë mrapa;*
- Delja: *janë nërzu delet; kan ra n'dash etj.*
- Mace: *ka ra maca n'dac, macja dhe qeni ka ra n't'njekun;*
- Pelë: *ka n'kal mu përcan n'kal;*
- Gomari: *a përcan me gomar, kan ra n t njekun;*
- Pulën e ka shkel gjeli, *ka:n ra pulat n gjel etj.*

Në të njëjtën mënyrë kryesisht në mënyrë metaforike, po edhe me anë të shtesave dhe ndërrimeve fonetike të ndryshme formohen eufemizmat për organet gjenitale të kafshëve si: *t lemt* për organin gjenital të lopës, dhisë, deles; *koqet* për organin gjenital të cjamin etj.

Ylberi: *Ka dalë vojufulla, delni shpejt e kapërceni.*

Grua e pandershme: *bishtpërdredhun, e pahajre, dredhalake, ladruce, por përdoren edhe shprehjet: Sa faqezezë gruja e filanit është gjet ven e pa ven; gruja e filanit sa e poshtme me e njek ate rrugë cfa:r burrit ka:; se kam menue se është njasi gruje gruja e filanit etj.*

Hëna: Edhe hëna përdoret si mjet tabu në këtë zonë. Njerëzit zakonisht nuk fillojnë një punë pa parë hënë. *Kur njerëzit martohen hëna duhet të jetë e re, është mir me u martu me ha:n të re, me ha:n përpjet/me ha:n t're vehen pulat me ç:l/me ha:n t're mjellen bimnat/priten flo:kt me ha:n të re për me lshu shu:m. Me hâ:n të vjetër priten lanë/pritet kallamoqi nuk presh e rasat merret kosa/ec ma mir kallamoqi ma:n ma shu:m. Kur hëna është e re thuhet ka bá hana. Kur hëna del priher me akshamin është përgjysmë. Hana ka dit e veta, mjedisi i hâns kur bahet 15 ditsh bâhet rrumullak. Hana kur i bân dy javë sé më sé, rrumullak. Me ha:n të pjekun mjellen bimnat me kalu nî e xhuma, se shlon to:j, ba:jn loze shumë. Kur hana i ka thepat përpjetë koha është e mirë kur hana i ka thepat ka deti bjen shî.*

Ujku është një nga kafshët e egra mishngrënëse që vazhdimisht i ka sjellë dëme blegtorisë. Bariu e ka pasur frikë, pasi ai grabiqar i ka dëmtuar kopenë, duke ia ngrënë, prerë apo rrëmbyer. Te ai jetonte mendimi se po t'i zije në gojë emrin, ai të dilte përpara. Për këtë përdornin eufemizmat si: *Ka ra bisha n'dhen; ka dalë aj i malit ruj mos t'na i hajn gjanë e gjallë; doli mylljazogojën; ra mullizotgojen.* Përdoret edhe emërtimi *râ bisha n'dhen /Po u përmend shpesh emri i ujkut ose dheltnes thonë se del. Kur del ujku e nuk shlohet n'bagti thonë ka ra me gojë mëll/ është i ngijshëm etj.*

Gjarpëri është një nga zvarranikët i cili sjell frikë, për këtë përdoren eufemizmat të cilat dallohen për sinoniminë e tyre si: *ka dal buci, rrshaja, breva, bullari etj. ...e ka haner buci bagtin/e ka prekë fiera lopen, dhinë etj. Rrshaja e papame qi nuk e ka pa kush bahet kulshedër.* Simboli i gjarpërit dëshmon për vazhdimësinë iliro-shqiptare dhe del si totem tek Ilirët. (Osmani:19). Në Postrisë besohet se po shikove dy gjarpërinj duke u zënë atëherë në shtëpinë tënde ka vdekje. Gjarpërin si mbrojtës të vatrës familjare e gjejmë edhe te Ilirët, madje në disa raste ai simbolizon shëruesin dhe mbrojtësin e njerëzve, ashtu si ujku dhe orët.

Bleta. E veshur me tabu ka qenë edhe bleta, e cila nuk duhej mallkuar. Ajo jeton aty ku ka njerëz të mirë. Në Postrisë thuhet se në qoftëse njerëzit e shtëpisë zihen ajo ikën. Në shumë vise të Shqipërisë kjo qenie mbahet si e shenjtë. Për t'i bërë shërbim caktohej e zonja e shtëpisë e cila mendohej se është njeriu më i mirë dhe me pamjen e jashtme. Fjala *bletë* del si element leksikor vendës. Në Postrisë ndeshim toponimet *shkambi i Bletës, Lugubleta.*

Shtojzavalle: *Kan dalë qoshin t'bardha, qato qî bashin naten e mi:r etj. Xhint janë ke:n shtojzavallet.*

Beqare: lëneshë, *Ia mëll rrisku, Ja mëll fati si me pa gjujt zotin gur.* Ndeshim urimet: *tu haptë fati!; e pastë falë zoti me jetë të gjatë!* etj.

Mallkim: *Kur na:m nî send të raftë pika, kur njeriu pendohet e kthen mallkimin duke prekur një anë të shtëpisë duke thënë thënien “gurit e malit t'shkret”.*

Morrat: kacabuj, kopaça. *Qyqja m ka xanë djali kacabuj, ose më ka xân djali.* Me kene nevrík të kcejnë kacabujtë= nervat. *Ka xan fmija kopaca qyqja û!*

Urithi: *yri. I ka kput yri bimnat; Ai djali asht yri= në kuptim figurativ i bën punët fshehurazi.*

Djali: *dreq, nalet, tobestak, dexhall p.sh. e ka marrë dreqi; âsht shu:m i shkatht tobestaku; Nalet i lejoftë shejtanit, I ka hî dexhalli n'bark etj.*

Kripa: Njelmues. *Merre do njelmues edhe hukate se pati msysh; Gjellen e njelmoi shumë.* *Shikoj kripën =shikoj fatin etj.*

Nusja e lales: bukël. Emërtimet eufemistike shpeshhërë kanë ngjyrim të theksuar zbutës, siç shprehet populli ta marrë me të mirë atë që emërton. *Tanë mijtë i hangri bukla etj.* Kjo kafshë e shpejtë e shkathët dëmton veçanërisht pulat, fshatari nga frika se mos i hante pulat nuk i zinte në gojë emrin, por nga ana tjetër ajo largonte minjtë etj.

Vjedhës: *e ka doren me zâm, i njet dora; e ka doren e gjatë, e ka dorën e keqe, cub, pirac etj. E ka ves piraci me pas tan pasunin e boten pa marre diçka nuk e len.*

I dobët: *e ka fmin si të pimë mizash; âsht si me e pã thã n tym etj.*

Eufemizmat janë një material gjuhësor që hedh dritë mbi fjalëformimin ose mbi ndërtimin e strukturave më të ndërlikuara si togfjalëshi e fjalia.

Eufemizmat të mbledhura në këtë zonë janë fjalë të parme, ose të prejardhura në bazë të kalimeve metaforike, metonimisë dhe sinekdotës me synimin që të mos përdoren fjalë të caktuara si. p.sh. *i shkreti, i ndjeri* për të vdekurin, por pjesa më e madhe dalin si togëfjalësh metaforikë: *e ka hanër livadin; shkoi te të shumtët etj.* Ndeshim edhe fjalë të përngjitura, të përbëra që janë pasojë e cingimit e fjalive dëshirore si: *qoftëlargu, mullazotgojen etj.* Eufemizmat fjali paraqiten dy llojesh: Fjali të thjeshta të paplota, si: *është me da:η, u bâ me fëmijë, âsht me na:m etj.* Fjali të përbëra me pjesë të nënrenditur përcaktore. *Aj qî i qofshim falë; Aj qî i kan bijt therrat mî trup etj.*

Edhe për sa u përket vlerave kuptimore “*sinonimia e eufemizmeve dëshmon jo vetëm pasurinë, por edhe lashtësinë e një gjuhe.*” (Biba 2004:39). Të gjithë shembujt e mbledhur na bëjnë të arrijmë në përfundimin se në ndërgjegjen popullore njerëzit kanë besuar te forca e fjalës, sa zhdukjen e fjalës e lidhin me zhdukjen e vetë objektit. Prania e një vargu të gjatë sinonimesh eufemistike, përveçse janë dëshmi interesante e një faze të hershme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, tregojnë këndvështrime, botëkuptime ose mendësi të ndryshme dhe në shkallë të ndryshme zhvillimi shoqëror ose kulturor. Sinonimet në këtë të folme janë të shumta si për gjarpërin përdoren: *buci, rrshaja, breva, bullari etj.*

Gjithashtu në mes eufemizmeve ndeshim edhe fjalë **homonime**.

- *Ajo* – gruaja e thirrur nga bashkëshorti.

- *Ajo* sëmundja e epilepsisë *ajo qî i ra:ft gurit e murit etj.*

Eufemizmat kanë vlerë të madhe në ndërtimet metaforike si: *fluturoi n qiell, e hanri livadin, shkoi për fiq etj.*

Eufemizmat mund të jenë edhe njësi frazeologjike të cilat qëndrojnë më lart me vlerat artistike. Të tilla janë: *Ta hangsha çorbën!* Mallkim vdeksh. *Çorba* është gjella që shërbehet për vdekje në krahinë e Postribës. Shumica e këtyre njësive frazeologjike janë të motivueshme nga ana kuptimore, sepse përdoren në të dy planet gjuhësore në atë real dhe në atë figurative dhe kjo

dukuri dëshmon zhdërvjelltësinë e gjuhës sonë. Shembuj të tillë janë të shumtë. Po sjellim disa prej tyre:

- **Dredh bishtin** bën gjëra të pamoralshme. *Nuk i bjen n men për rangt e shpisë rrin tuj dredh bishtin tan ditën e lume.*

- **Ësht dora vetë** hajdute. *Mos e merr n pun nshpi se është dora vetë, nuk len len gja pa prek.*

- **E ka gabzherrin shkurt** e qet fjalën pa e menduar, fjalën e fundit e qet n'fillim. Është një njeri që nuk duron shumë dhe nuk e mban diçka të fshehtë, flet pa u matur dhe pa u menduar mirë, trashaman. *Menoju kur flet e ke gabzherrin shkurt, nuk i ke menu shu:m gjanat.*

- **Tra i palatum.** Njeri i pamend, trashaman. *Qaj njeri nuk din kurrisen asht tra i palatum.*

Me të drejtë është theksuar se: “Eufemizmat dhe përvetësimi i njohurive për to janë një lojë e vazhdueshme në mes gjuhës dhe shoqërisë. Ato janë një ndër mekanizmat që flasin bindshëm se gjuha, sidomos në aspektin e saj pragmatik dhe kjo nënkupton gjatë përdorimit të saj, nuk mund të paramendohet e shkëputur nga shoqëria.”⁹⁶ Duke i gjurmuar është e mundur të kuptohet *se çfarë ka ndodhur ose po ndodh në gjuhën tonë, mendjen tonë dhe kulturat tona.*⁹⁷

Përfundimi

Krahina e Postribës, krahas pasurisë së fjalëve së fjalëve dhe njërive frazeologjike është e pasur edhe me eufemizma, të cilat përdoren për të zëvendësuar ato emërtime që banorët e kësaj krahine nuk duan t'i shprehin me emrin e tyre të vërtetë, dhe në këtë rast ato përdorin shprehje me kuptim më të zbutur.

Eufemizmat përdoren për të zëvendësuar emërtime për sëmundjet, për vdekjen, për lindjet, për shtatëzaninë, për kafshët dhe proceset e fekondimit, për hënën, për emërtimin e bashkëshortit/bashkëshortes etj. Ato janë të pasura edhe përsa i takon lidhjes kuptimore të fjalëve. Dalin të larmishme në sinonimi, ku për të njëjtin objekt apo dukuri gjejmë disa njësi sinonimike si: për gjarprin=*breva, bullar, fiera* etj.

Eufemizmat janë produkt gjuhësor i një shoqërie, ato janë dëshmi e traditës dhe vijimësisë gjuhësore të një populli dhe, si çdo përftesë tjetër historike dhe social-kulturore, ato janë shprehje e ruajtjes së veçorive kombëtare të gjuhës. Ato janë shprehje gjuhësore pa të cilat gjuha dhe komunikimi nuk do të mund të realizohet e të mishërohet në larminë dhe harmoninë e duhur.

Ato kanë rëndësi edhe për gjuhësinë dhe leksikogjinë historike, ku dukuria e tabusë paraqet interes të padiskutueshëm, meqenëse na jep mundësi të kuptojmë zhvillimin e fjalëve të veçanta dhe zëvendësimin e tyre me fjalë të tjera. Sfera e përdorimit të eufemizmave është e gjerë. Ata shërbejnë edhe për pasurimin e fjalorit të një gjuhe.

⁹⁶ Durmishi I. *Eufemizmat si dukuri gjuhësore me karakter sociolinguistik*, Seminari VI Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2012, f. 266.

⁹⁷ Rawson H. *A dictionary of euphemisms and other doubletalk*, New York, Crown Publishers, 1981, f.1.

Referencat

- [1]. AA VV, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, bot. i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), Tiranë, 1980.
- [2]. AA VV, *Fjalor i shqipes së sotme*, bot. i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2006.
- [3]. Kostallari A. Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes, “*Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*”, nr.I, Tiranë, 1972, f.184-190.
- [4]. Holder B. *A Dictionary of Euphemisms, How Not To Say What You Mean*, Oxford, New York: Oxford University Press, 2008.
- [5]. Warren B. What euphemisms tell us about the interpretation of words, *Studia Linguistica*, 2, 128-172.
- [6]. Çabej E. Disa eufemizma të shqipes, *Studime Gjuhësore*, 4, Prishtinë, 1977, f. 17-23 & Buletin i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1949, III, f.72-84.
- [7]. Çabej E. Disa figura të besimeve popullore shqiptare, në “*Studime Gjuhësore*”, 5, Prishtinë, 1976, f. 153-161.
- [8]. Çabej E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, VII, Tiranë, 2005.
- [9]. Biba E. Eufemizmat në “ligjërimin grarisht” të trevave të Korçës, “*Buletini shkencor*” i Universitetit “Fan S. Noli”, nr. 8. (2004), f. 36-40.
- [10]. Shkurtaj Gj. *Vlerat etnolinguistike të këngëve të festave popullore në rrethin e Korçës*, “Buletini Shkencor” i Universitetit “Fan S. Noli”, nr.6. (2004), f. 18-22.
- [11]. Shkurtaj Gj. Eufemizmat si shprehje e etnografisë së të folurit grarisht, *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë 2015, f.259-270.
- [12]. Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 1999, 2009.
- [13]. Shkurtaj Gj. *Vështrim sociolinguistik për fjalët zot, perendi, Allah* (Sprovë për një shqyrtim paraprak), në Sociolinguistika, SHBLU, Tiranë, 2003, f.230.
- [14]. Shkurtaj Gj. *Disa shqyrtime rreth eufemizmave të shqipes sipas ideve të Eqrem Çabej*. Studime shqiptare 9, Çabej, 1998, f.86-97.
- [15]. Rawson H. *A Dictionary of Euphemisms and Other Doubletalk*. Neë York: Croën Publishers, Inc. 1981.
- [16]. Durmishi I. *Tabutë dhe eufemizmat*, Seminari IV Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2010, f. 116-123.
- [17]. Durmishi I. *Eufemizmat si dukuri gjuhësore me karakter sociolinguistik*, Seminari VI Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2012, f. 264-272.
- [18]. Durmishi I. *Eufemizmat si shprehje tipike e gjuhës së grave*, “*Studime Sociolinguistike*”, 2014, nr.2, f.66-72.
- [19]. Durmishi I. *Funksionalizmi si metodë gjuhësore tek eufemizmat*, “*Albanologjia*”, vol. 3, nr.5-6, f. 28-32, Tetovë, 2016.
- [20]. Durmishi I. *Ndërlidhja e eufemizmave me luftën*, botuar në “*Albanologjia*”, nr.7/2017, f. 49-52.
- [21]. Thomaj J. *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010.
- [22]. Allen K., Burridge K., *Euphemism and Dysphemism: language used as shield and weapon*. Oxford: Oxford University Press, 1991.
- [23]. Ibrahim M. Eufemizmat e shqipes në rrafshin krahasues me kulturat ballkanike sipas Çabejt, në Konferenca IV Shkencore Ndërkombëtare “*Eqrem Çabej-figura që shkëlqeu në studimet albanologjike*”. Tetovë 19-20 dhjetor 2008, f. 84-93, UEJL, Tetovë, 2009.
- [24]. Ibrahim M. *Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmave shqiptare*, Interlingua, Shkup, 2009.
- [25]. Murati Q. *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës*, Prishtinë, 2018.
- [26]. Murati Q. *Fjalor i shqipes truallësore të Maqedonisë*, Tetovë, 1998.
- [27]. Pepa S. *Mbi disa eufemizma të shqipes veriore*, BSHSH; nr. 2, Shkodër, 1992.
- [28]. Osmani T., Pepa S. *Pasqyrimi i eufemizmave në letërsinë gojore dhe artistike*, “Buletin Shkencor”, nr. 1. Shkodër, i Muzeut historik, Shkodër, 1995-1996.
- [29]. Osmani T., Pepa S. *Rreth tabuve dhe eufemizmave në gjuhën shqipe për botën e kafshëve*, Kumtari i Muzeut Historik, Shkodër, 1995, f. 127.v.
- [30]. Osmani T., Pepa S. *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2000.
- [31]. Osmani T., Pepa S. Vëzhgime për disa eufemizma të shqipes, “*Gjuha Jonë*”, nr.1-2, 1992, f. 29-31.
- [32]. Bexheti V., Xhaferi H., Ibrahim M. *Studime etnolinguistike, folklorike dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni*, Shkup, 2008.
- [33].